



Në bazë të dispozitave të Nenit 21 paragrafi 21.3 të Ligjit për Ndërmarrje Publike me nr.03/L-087 respektivisht dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike Lokale, Neni 30 pika 30.1.8 i Statutit të NPL "Kastrioti" Sh.A Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 21.06.2023 Obiliq, me datë 30.06.2023 shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Pozita: KRYESHEFI EKZEKUTIV

Përgatitja shkollore: Fakulteti Ekonomik, Juridik apo të ndërlidhura në këto fusha

Orari i punës: i plotë

Kohëzgjatja e kontratës: 3 vite

Vendi: Obiliq

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomë universitare në fushat ekonomike, juridike apo të ndërlidhura në këto fusha
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushte me veprimtarinë afariste të NP-së,
- Shkathtësi të dëshmuara njerëzore, etike dhe të menaxhimit të një ndërmarrje ose organizatë të ngjashme,
- Shkathtësi të mira kompjuterike,
- Njohja e gjuhës angleze e preferueshme,
- Aftësi komunikuese



Punët dhe përgjegjësitë e punës:

- Në bashkëpunim me Zyrtarët e tjerë të Ndërmarrjes zbaton politikat zhvillimore të Ndërmarrjes, të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve,
- Është përgjegjës për zhvillimin e aktivitetit të përditshëm të ndërmarrjes,
- Në bashkëpunim me zyrtarët tjerë të ndërmarrjes harton dhe i propozon për aprovim Bordit të Drejtorëve, planin e biznesit të Ndërmarrjes,
- Posaçërisht kujdeset për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të Ndërmarrjes gjatë kontaktit me media dhe palët e treta,
- I raporton dhe i përgjigjet Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes,
- Kryen dhe punë tjera të caktuar me ligj dhe me Statut të Ndërmarrjes.

Procedurat e Konkurrimit:

Kandidati-ja për këto pozita duhet t'i dorëzojnë këto dëshmi:

- CV,
- Kopjen e letërnjoftimit
- Letër Motivuese,
- Dëshminë e kualifikimit,
- Dëshminë për përvojën e punë, bashkangjitur listën e Trustit pensional,
- Certifikatën e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar (jo më e vjetër se 6 muaj),
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale

Dokumente e kompletuara duhet të dorëzohen përmes e-mailit zyrtar:

bordi.nplkastrioti@gmail.com

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur nga data 01.07.2023 deri me 30.07.2023